

Bazuar në ligjin 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar Agjencia e Inteligjencës Financiare Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) organizohet si drejtori e përgjithshme në varësi të ministrit përgjegjës për financat dhe ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës sipas këtij ligji.

Kjo Agjenci brenda fushës së veprimtarisë së vet ka të drejtë të vendosë për mënyrën e ndjekjes dhe të zgjidhjes së çështjeve të trajtuara për pastrimin e mundshëm të parave dhe financimin e veprimtarive të mundshme terroriste, si dhe ka për kompetencë realizimin e inspektimeve në vend dhe në distancë.

Në përfundim të inspektimit bazuar në Vendimin nr.871, datë 14.12.2011 “Për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative” Drejtori i Përgjithshëm, pasi vlerëson dhe analizon praktikën e inspektimit dhe propozimin e komisionit të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, merr vendim për vendosjen e masës administrative ndaj subjektit të ligjit apo pushim te procedimit të kundërvajtjes administrative dhe njofton zyrtarisht subjektin.

<https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Publikim.pdf>